



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep Dip Dip	DPKI
Nr. Prot Br. Prot Prot No	06-02/4233/22
Data Datum Date	24.10.2022
Nr. Titull Titull Titull	03
Nr. Pajisje Pajisje Pajisje	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.10.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-3720/22, për zyrtaren e lartë znj. Lule Ahmedi, Anëtare e Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren znj. Lule Ahmedi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi anonim, ka filluar trajtimin e rastit me pretendimin se, sipas Vendimit nr. 226 i datës 18.02.2022 të Universiteti të Prishtinës (neni 6), znj. Ahmedi nuk mundet që si ligjërues në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit të Prishtinës, njëkohësisht të jetë edhe anëtare e Bordit në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, e cila gjithashtu është edhe anëtare e Bordit Drejtues Profesional të Shkollës NYSS.

Sipas procedurave të Agjencisë, znj. Ahmedi përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-02/3961/22) është njoftuar për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konflikti të interesit. Pas pranimit të njoftimit të Agjencisë nga znj. Ahmedi, me të njëjtën është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me c’rast janë ofruar informata dhe dokumentacione plotësues nga zyrtarja e lartë.

Lidhur me këtë, Agjencia pas mbledhjes dhe analizimit të dokumentacioneve relevante, si dhe bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka gjetur se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Kjo për faktin se vendimi (neni 6) të cilit i është referuar raportuesi i rastit, parasheh kufizimi vetëm sa i përket themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës (me orar të plotë) jashtë universitetit nga personeli i akademik që janë në marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e Prishtinës. Respektivisht, neni 6 i Vendimit Nr. 226 i datës 18.02.2022 të Universiteti të Prishtinës, përcakton se:

“Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP, i ndalohet të themeloj marrëdhënie të rregullt pune në një institucion publik ose privat, vendor apo ndërkombëtar, brenda apo jashtë vendit. Gjithashtu, personeli akademik nuk mund të ketë marrëdhënie të rregullt pune me UP-në dhe të jetë i emëruar në një institucion publik ku natyra e emërimit të tij dhe ngarkushmëria në kuptim të angazhimit do të përputhej me specifikat e marrëdhënies së rregullt të punës, pra qëndrimi në zyre brenda një orari të rregullt të punës i cili përputhet me orarin e rregullt të punës në UP (gjyqtar, prokuror, ministër, këshilltar politik, shef ekzekutiv, e të ngjashme, si dhe angazhime të tjera që ndikojnë në mospërbushje të detyrave të UP). Nuk përjashtohen mundësit e angazhimit që i njuhë Ligji i Punës në Kosovës dhe angazhimet apo emërimet specifike në trupa/organe kolegjiale me funksion mbikëqyrës në institucione dhe agjenci publike të pavarura, me ngarkushmëri siç përcaktohet me dispozitat e këtij vendimi, e që nuk cilësohet marrëdhënie e rregullt pune, ose përjashtohen nga marrëdhënia e rregullt e punës e njohur sipas ligjeve në vend dhe që në asnjë rrethanë nuk ndikojnë në përmbushjen e detyrova e të punës në UP.”

Ndërsa, sipas Vendimit Nr. 1/189 i datës 08.07.2021 të Universiteti të Prishtinës “Hasan Prishtina”, znj. Ahmedi i është pezulluar vendi i punës në Universitetin e Prishtinës dhe atë deri sa të njëjtës t’i përfundoj mandati si anëtare e Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronik dhe Postare, e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Vendimit Nr.163/2/21 i datës 01.06.2021.

Ndërsa, sa i përket pretendimit se znj. Ahmedi mban edhe pozitën e anëtares së Bordit Drejtues Profesional të Shkollës NYSS, e njëjta me shkrim ka deklaruar se nuk është pjesë e bordit të shkollës në fjalë.

Andaj, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe dispozitave ligjore përkatëse, Agjencia ka gjetur se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për


DPKI 10

konflikt të interesit, ashtu siç përcakton Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

